



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:164152

Datë: 12.04.2022

Numri i dokumentit: 02905885

P.nr.992/20 (2020:164153)

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani me Zyrtarin ligjor Gent Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurve A. L., nga Ferizaji, rr ”, banesa nr....., për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.1 lidhur me par.3 të Kodit Penal të KPRK-së dhe A. O., nga fshati ..., Komuna Lipjan për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.2 lidhur me paragrafin 4 dhe 5 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1121/2020, e datës 24.11.2020, ka mbajtur shqyrtimit fillestar 04.04.2022, në prani të Prokurorit të shtetit Mimoza Syla Hyseni të pandehurit A. L. dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av.Fatos Zeqiri, i pandehuri A. O. dhe i dëmtuari B. O., kurëse me datën 12.04.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurëve:

1. A. L., nga Ferizaji, rr” ”, banesa ..., nr....., i lindur më ..., nga i ati I. dhe e ëma K., mbiemri i vajzërisë B., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin, i martuar, pronar i kompanisë “...” me gjendje te mesme ekonomike, me nr. Lnj....

2. A.O., nga fshati....., Komuna Lipjan, i lindur më nga i ati I. dhe e ëma N. e gjinisë E., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin, i martuar, prind i dy fëmijëve, me gjendje te mesme ekonomike, menaxher në firmën “ ... ”, me nr. Lnj....

-I-

I pandehuri A. L.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

- Gjatë muajit Qershor 2020, në rrugën “ ”, në vend punishten e kompanisë “ ... ”, duke qenë përgjegjës për të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë dhe për të krijuar kushte të sigurta të punës nga pakujdesia nuk ka ndërmarrë masa për parandalimin e rreziqeve duke rrezikuar jetën e njerëzve në atë mënyrë që në vend punishten ku ka qenë duke ndërtuar një ndërtesë –kompleks banesor, derisa e kanë bërë gërmimin e dheut, nuk ka ndërmarrë masat mbrojtëse për pengimin e shembjes së dheut si dhe pas gërmimeve nuk ka ndërmarrë masa të përshtatshme mbrojtëse si përdorimi i pendave mbrojtëse apo pjerrinave në mënyrë që punëtorët të punojnë të sigurt,-

- me të cilën ka kryer veprën penale **Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.1 lidhur me par. 3 të KPK-së.**

-II-

I pandehuri A. O.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

- Me 18 Qershor 2020, rreth orës 13:30, në rrugën “ ”, në vend punishten e kompanisë “...”, duke qenë përgjegjës për të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë dhe për të krijuar kushte të sigurta të punës nga pakujdesia nuk ka ndërmarrë masa për parandalimin e rreziqeve duke rrezikuar jetën e njerëzve në atë mënyrë që ka angazhuar punëtorin - të dëmtuarin B. O. në kryerjen e punëve në themelin e objektit ndërtimor në të cilin nuk kanë qenë të vendosura masat mbrojtëse për parandalimin e rreziqeve në punë me ç ‘rast

ka rrezikuar punëtorët, ka rrëshqitur dhe duke e zënë punëtorin - të dëmtuarin B. O. në këmbën e majtë, i cili ka pësuar dëmtime të rënda trupore të përshkruara si në ekspertizën e datës 12.10.2020,-

- me të cilën ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.2 lidhur me par. 4 dhe 5 të KPK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 23, 38, 40, 44, 69, 70 71,72, si dhe në bazë të neneve 365, 450, 453, 463, të Kodit të Procedurës penale të Republikës së Kosovës (KPPK), të pandehurit i:

G J Y K O N

I. Të pandehurin A. L., i shqipton dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 300 / treqindën / Euro, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/ , në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Po ashtu obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

II. Të pandehurit A. O. i shqipton dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 450 / katërqind pesëdhjetë / Euro, dënimin e

shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Po ashtu obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit B. O., nga fshati Komuna e Lipjanit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.1121/2020 të datës 24.11.2020, kundër të pandehurve A. L., nga Ferizaji, rr "...", banesa ..., nr...., për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.1 lidhur me par.3 të Kodit Penal të KPRK-së dhe A.O., nga fshati ..., Komuna Lipjan për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.2 lidhur me paragrafin 4 dhe 5 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate, dhe është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale për të cilën janë proceduar të pandehurit gjykohen nga gjyqtari i vetëm gjykues.

Lidhur me këtë çështje penale Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 04.04.2022, me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Mimoza Sylja Hyseni, i pandehuri A.L.dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av.Fatos Zeqiri, i pandehuri A.O. dhe i dëmtuari B.O.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat dhe detyrimet e tyre në kuptim të nenin 323 par. 1 dhe 2 të KPPRK-se ku të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se të pandehurit për verat penale që akuzohen veç e veç si në dispozitiv të aktakuzës, të pandehurve në kuptim të nenit 246 par. 4 të KPPRK-së i ofrojë mundësinë e deklarimit të tyre rreth fajësisë-të pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri A. L., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet siç është përshkruar në pikën e par të dispozitivit të aktakuzës, i vie keq që i ka ndodh të dëmtuarit B., por për gjendjen e tijë shëndetësore dhe materiale i kanë ndihmuar së bashku me A.O.n, por kjo ka ndodhur nga pakujdesia jo me dashje ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit që t'i ketë përsysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ti shqipton një dënim sa më të butë.

I pandehuri A.O., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale siç është përshkruar në pikën dy në dispozitiv të aktakuzës, i vie shumë keq që ka ndodh, punëtorit të dëmtuarit B. ku e ka edhe të afërm-kushëri, e ka ndije vetën shumë rëndë lidhur me ket rast që i ka ndodhur të dëmtuarit, por nuk i është shkaktuar me dashje. Për gjendjen shëndetësore dhe materiale së bashku me A. kanë arritur një Marrëveshje që për 24 muaj ti bëjnë kompensim të të ardhurave në mënyrë solidare secili nga 150 € (njëqind e pesëdhjetë) ku jemi duke i paguar, kërkon nga gjykata që me rastin shqiptimit të dënimit për veprën penale që akuzohet të merrë për bazë rrethanat lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit të dëmtuarit dhe mbrojtësit të të pandehurit A.L.me autorizim Av. Fatos Zeqiri lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve pasi pranimi i fajësisë për të dy të pandehurit për A.L.dhe A.O. për pikën I dhe II të kësaj aktakuze meqë i njëjti pranim është i bazuar me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë të pandehurit e kanë bërë vullnetarisht dhe një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozon gjykatës që të bën pranimin e fajësisë.

I dëmtuari B.O., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ka deklaruar se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk paraqes kërkesë pasurore juridike dhe i njëjti deklaroi e është e vërtetë se me të pandehurit ka arritur marrëveshje për lëndimet që ka pësuar dhe të njëjtit e kompenzojnë në muaj në shumë pre 300 Euro / treqind / euro.

Mbrojtësi i të pandehurit A.L.me autorizim Av. Fatos Zeqiri ka deklaruar se e mbështetë deklarimin e të mbrojturit të tij A.L.për pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me Kodit Penal si dhe nga rrethanat dhe provat të cilat janë të bashkëngjitura në aktakuzë. Kërkon nga gjykata që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese e sidomos pranimin e fajësisë keqardhjen për rastin e ndodhur, ofrimin e ndihmës palës së dëmtuar, si dhe të ketë parasysh se kjo veprë është kryer nga pakujdesia e jo me dashje, Gjykatës i propozon që të mbrojturit të tij ti shqiptohet dënim me gjobë me qëllim që të mos mbetet në evidencë dhe të mos krijoj pasoja për të mbrojturin etij pasi që bazuar në KPRK të ri penal dënimi me gjobë nuk prodhon pasoja juridike.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nën par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se të pandehurit për veprat penale që akuzohen i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuar nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Duke pas parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1,1.2,1.3 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit pasi që janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së dhe me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë të të pandehurëve, ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje me provat formale- materiale të bashkëngjitura në aktakuzë siç janë raportet e oficerit, Raport Zyrtarë mbi aksidentin në punë nga Inspektorati i Punës Ferizaj i dt.05.08.2020, Kontratë Ndërtimi i Objektit Banesor dt.12.02.2020, raportet mjeksore, akt ekspertimi mjeko ligjore e dt.12.10.2020, deklarata e M. M.dhe L. O.e dt.30.06.2020, fotografit si dhe të shiqohen shkresat tjera të cilat gjenden në lëndë.

- Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit A.L.manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.1 lidhur me par. 3 të KPRK-së.

- Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit A.O.j manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.2 lidhur me par.4 dhe 5 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neneve 69 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit secilin veç e veç i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura - konfirmuara nga ana e prokurorit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se të pandehurit secili veç e veç e kanë pranuar fajësinë, të njëjtit kanë kërkuar falje për veprimet e tyre, me të dëmtuarin kanë arrite marrëveshje për kompensim të pagës mujore për njëzet e katër muaj dhe nga aksidenti janë interesuar pa ndërprerë për gjendjen e tij shëndetësore ku tani është më mirë, andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se këto dënime janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, për të pandehurit veç e veç u mur në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave është marrë në kuptim të nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.992/20 (2020:164153) me datë 12.04.2022

Zyrtari ligjor

Gent Mustafa

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.